



Pranuar / Dorezuar Prinjenoi/Prodato Received/Delivery	30.06.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSHICK	4994/2023		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.765/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.765/2023 të datës 19.05.2023 të parashtruar nga ankuesi

me adresë pune: kundër  
heshtjes administrative të Administratës Tatimore të Kosovës lidhur me kërkesën e datës 27.03.2023, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 30.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.765/2023 e datës 19.05.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohet Vendimi me shifër:11/04 i datës 27.04.2021 i Komisionit Disiplinor, Vendimi me shifër:10/2021 i datës 13.08.2021 i Komisionit Disiplinor dhe Vendimi me shifër:243 i datës 13.08.2021 i Drejtorit i Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

III. Mbetet në fuqi Akt Emërimi i ankuesit i datës 05.05.2017 me numër 02/600/09 sipas të cilit i njëjti ka qenë i emëruar në pozitën "Drejtor i Drejtorisë Rajonale në Gjilan" Departamenti-Shtylla Funktionale Operacionet në kuadër të ATK-së.

IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës sipas Aktit të Emërimit të datës 05.05.2017.

V. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që ankuesit t'i bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës në pagë dhe atë që nga data 13.08.2021.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

## Arsyetim

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës (*tani e tutje ATK*), me datë 19.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me Numër protokoli:4357/2023, kundër heshtjes administrative të Administratës Tatimore të Kosovës lidhur me kërkesën e tij të datës 27.03.2023 drejtuar Komisionit Disiplinor.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon Komisioni Disiplinor ka heshtur ndaj kërkesës së tij të datës 27.03.2023 përmes së cilës ka kërkuar nga kryesuesi i këtij komisioni që të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore ngase i njëjti sipas Aktvendimit PKR.nr.249/22 të Gjykatës Themelore në Gjilan të datës 10.02.2023 është liruar nga përgjegjësia pasi që aktakuza e ngritur ndaj tij është hedhur poshtë dhe se ky fakt përbën shkas që Komisioni Disiplinor të vendos meritorisht për rastin, pasi që sipas Vendimit Nr.11/04 të datës 27.04.2021 Komisioni Disiplinor e kishte pezulluar rastin ndaj ankuesit deri në vendosjen meritorie nga organet përgjegjëse. Tutje, përveç tjerash ankuesi pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e trajtimit të rastit të ankuesit e ka diskriminuar të njëjtin në mënyrë sistematike gjate vendimmarrjes madje ka tejkualuar kompetencat funksionale ndërlidhur me shqiptimin e masave disiplinore apo veprime të tjera administrative në emër të masave disiplinore, me kërkesën që Këshilli të shfuqizojë Vendimin me shifër:10/2021 i datës 13.08.2021 Komisioni Disiplinor dhe Vendimin me shifër:243 i datës 13.08.2021 i Drejtorit i Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, Vendimin e datës 12.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe Akt Emërimit e datës 13.12.2022 lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të ATK-së si dhe të detyroi ATK-në që t'ia kompensojë ankuesit diferencën në pagë në mënyrë retroaktive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.05.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Administrata Tatimore të Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 26.05.2023 ka pranua nga Administrata Tatimore të Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokoli: 765/2023, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 19.05.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 19.05.2023 dërguar nga ankuesi në Këshill; E-mailin e datës 27.03.2023 dërguar nga ankuesi për me korrespondencën e bashkangjitur prej dy faqesh me kërkesën e bashkangjitur të datës 27.03.2023; Aktvendimin PKR.nr.249/2022 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda të datës 10.02.2023; Aktvendimin PN.nr.250/2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 07.03.2023; E-mailin e datës 04.05.2023 dërguar nga ankuesi për I.I me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; Akt emërimit e ankuesit të datës 13.12.2022 me shifër .Nr.28/2022; Vendimin e datës 12.12.2022 të Zëvendësueses së Drejtoreshës të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Akt Emërimit e ankuesit të datës 05.05.2017 me shifër:02/600/09; Vendimin nr.02/2021 të Komisionit Disiplinor i datës 07.04.2021; Vendimin Nr.prot:86 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së i datës 15.04.2023; Vendimin nr.02/1/2021 të Komisionit Disiplinor i datës 26.04.2021; Vendimin Nr.prot:242 të Komisionit Disiplinor i datës 11.08.2021; Vendimin Nr.prot:10 të Komisionit Disiplinor i datës 13.08.2021;

Vendimin Nr.prot:243 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së i datës 13.08.2021; E-mailin e ankuesit të datës 22.05.2023 dërguar në Këshill; Padinë e ankuesit të datës 05.11.2021; Dëftesa e datë 08.11.2021; E-mailin e datës 23.05.2023 dërguar nga Këshilli për ATK-në për përgjigje në ankesën e ankuesit; Përgjigja e ATK-së e datës 26.05.2023; Shkresën Informuese të Policisë së Kosovës të datës 17.03.2023 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së; Njoftimin e Prokurorit të Shtetit të datës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen Ankesave e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Me qëllim të shqyrtimit të pranueshmërisë të ankesës së ankuesit lidhur me heshtjen administrative nga Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës ndaj kërkesës së ankuesit të datës 27.03.2023, Kolegji i Këshilli ka analizuar dispozitat e aplikuara ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 125 paragrafi 1 dhe nenin 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se: "125.1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative") dhe 127.4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ." ndërlidhur me nenin 98 paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: " 1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.", dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës vizave institucioni punëdhënës, ka heshtur ndaj kërkesës së ankuesit të datës 27.03.2023, pasi që nga shkresat e lëndës, gjegjësisht e-mailit të datës 27.03.2023 dëshmohet fakti se kërkesa në fjalë është pranuar nga zyrtari me inicialet i cili rezultoi të jetë Kryesues i Komisionit Disiplinor, nga rrjedh se sipas dispozitave ligjore të përcaktuara si më lartë të njëjtit kanë qenë të obliguar që të vendosin brenda afatit prej 45 ditësh lidhur me kërkesën e ankuesit, e që rezultoi të jetë data 11.05.2023, nga rrjedh se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill me datë 19.05.2023 kundër heshtjes administrative është bërë në pajtueshmëri me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, prandaj si e tillë ankesë është shqyrtuar meritorisht.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se, ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 05.05.2017 me numër:02/600/09 ka qenë i emëruar në pozitën "Drejtore i Drejtorisë Rajonale në Gjilan" Departamenti-Shtylla Funksionale Operacionet në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, respektivisht akti i emërimit të ankuesit ka qenë i karrierës pa afat të caktuar.

Pas njoftimit të datës 17.03.2021 nga Policia e Kosovës dhe njoftimit të datës 31.03.2021 nga Prokurori i Shtetit për Drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, se ndaj ankuesit është ngritur kallëzim penal me dyshimin se i njëjti ka "keqpërdorur pozitën apo autoritetin zyrtar" dhe "marrje ryshfeti", Komisionin Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës me datë 15.04.2021 ka nxjerrë Vendimin Nr.02/2021 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar në një lokacion tjetër deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Komisionit Disiplinor me qëllim që ankuesi mos të pengojë zhvillimin e hetimeve, ndërsa në mbështetje të vendimit të Komisionit Disiplinor, me datë 15.04.2021 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së nxjerr Vendimin

me shifër:86 përmes të cilit e transferon ankuesin në cilësi të masës disiplinore në pozitën Drejtor i Departamentit të Shërbimit ZGJONA Pr.1,2 dhe 3, kurse me datë 27.04.2021 Komisioni Disiplinor nxjerrë sërish Vendimin me numër:02/1/2021 përmes të cilit e pezullojnë procedurën disiplinore ndaj ankuesit të iniciuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, deri në përfundim të procedurës penale nga organet përgjegjëse.

Tutje, Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së me datë 11.08.2021 nxjerrë Vendimin me shifër:242 përmes të cilit e shfuqizon vendimin e Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së të datës 15.04.2021 me shifër:86, ndërsa lëndën e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor, ndërsa me datë 13.08.2021 Komisioni Disiplinor nxjerrë vendimin me shifër:10/2021 ku përmes pikës I të dispozitivit ankuesit i cakton vendosjen e masës së përkohshme-transferim në një pozitë pune tjetër deri në vendosjen përfundimtare nga Komisioni Disiplinor, kurse përmes pikës IV të dispozitivit e lë në fuqi vendimin paraprak të Komisionit Disiplinor të datës 27.04.2021 me shifër:11/04 përmes të cilit ishte pezulluar procedura e iniciuar disiplinore ndaj ankuesit, ndërsa me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së me datë 13.08.2021 nxjerrë Vendimin me shifër:243 përmes të cilit ankuesin e sistemon në mënyrë të përkohshme në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Koordinim të Projekteve në kuadër të Departamentit për Zhvillim dhe Koordinim të Projekteve në Zyrën Qendrore të ATK-së.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se Gjykata Themelore në Gjiilan-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktvendimit PKR.nr.249/2022 të datës 10.02.2023 e ka Hudhër aktakuzën e Prokurorisë, e ka pushuar procedurën penale ndaj ankuesit pasi që ka konfirmuar se ankuesi nuk ka kryer asnjë veprim përmes së cilit mund të nxirret ndonjë element i kryerjes së ndonjë veprimi që ka elemente apo përbën vepër penale, ndërsa po ashtu Gjykata e Apelit të Kosovës përmes Aktvendimit PN.nr.250/2023 të datës 07.03.2023 e ka vërtetuar Aktvendimin PKR.nr.249/2022 të datës 10.02.2023 të Gjykatës Themelore në Gjiilan-Departamenti për Krime të Rënda, dhe mbi këtë bazë në rrethanat e rastit konkret paraqitet situatë e re apo rrethanë juridike pas së cilës arsytimi i përdorur nga institucioni punëdhënës lidhur me transferimin e ankuesit përveç tjerash është i pabazë, ngase nga shkresat e lëndës lënë të kuptohet se transferimi i është shndërruar në masë disiplinore duke e ulur në pozitë pavarësisht që nga shkresat e lëndës vërehet se i njëjti nuk i ka shkelur dispozitat e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"* si dhe dispozitat e nenit 52, nenit 53 dhe nenit 54 i të njëjtit ligj lidhur me rregullimin që i bënë ligji material institutit të transferimit, gjegjësisht Transferimit të përkohshëm, Transferimit të përhershëm dhe Transferimit në rast mbylljes apo ristrukturimit, dhe ka ardhur në përfundim se me dispozitat e zbatuara të ligjit material, janë të përcaktuara qartë se cilat janë masat disiplinore që mund t'i shqiptohen nëpunësit civil, në mesin e të cilave nuk gjen vend apo nuk është e përcaktuar që transferimi mund të përdoret si masë disiplinore, sikurse që është përcaktuar qartë se në cilat raste dhe pas përmbushjes së parakushteve të caktuara ligjore mund të realizohet transferimi i nëpunësit civil, nga rrjedhe se në rastin konkret institucioni punëdhënës, respektivisht

Komisioni Disiplinor dhe Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës kanë interpretuar dhe zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material.

Nga se u tha si më lartë, duke u mbështetur në kronologjinë e vendimmarrjes së Komisionit Disiplinor dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, del që vendimet e kanë konsumuar fuqinë juridike të njëra tjetrës dhe aktualisht në fuqi janë Vendimi me shifër:11/04 i datës 27.04.2021 Komisioni Disiplinor, Vendimi i datës 13.08.2021 me shifër:10/2021 i Komisionit Disiplinor dhe Vendimi i datës 13.08.2021 me shifër:243 i Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së e mbi të gjitha Akti i Emërimit të ankuesit i datës 05.05.2017 me numër:02/600/09 sipas të cilit ankuesi rezulton të jetë i emëruar në pozitën "Drejtor i Drejtorisë Rajonale në Gjilan" Departamenti-Shtylla Funktionale Operacionet në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, i cili nuk është shfuqizuar me asnjë akt tjetër administrativ.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të Komisionit Disiplinor me rasti e nxjerrjes së Vendimit të datës 13.08.2021 me numër: 10/2021 mbi bazën e të cilit ankuesit i është vendosë masë e përkohshme-transferim në një pozitë pune e cila nuk do të cenoj ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij deri në vendimin përfundimtar të Komisionit Disiplinor, Kolegji i Këshillit ka marr përbazë dispozitat e nenit 48 paragraf 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik neni 11 ku përcaktohet se: "1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore." dhe ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor ka dal jashtë mandatit të përkufizuar ligjor ngase kompetencë të vetme e ka përcaktimin dhe shqiptimin e masës disiplinor pas zhvillimit të procedurës disiplinore, ndërsa interpretimi që komisioni disiplinor i ka bërë nenit 48 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është i gabuar ngase afati për vendosje përfundimtare nga ana e Komisionit Disiplinor në një procedurë disiplinore sipas nenit 12 paragrafi 6 të Rregullores nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik: "Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore", pra është 30 ditë, prandaj në rastin konkret Komisioni Disiplinor nuk ka mundur në emër të masës së përkohshme ta transferojë ankuesin pa afat të caktuar ndërsa procedurën e iniciuar disiplinore ta mbaj të pezulluar, ngase ligji material nuk ka paraparë apo përcaktuar në asnjë dispozitë të tij masë të përkohshme madje as si term juridik një çështje të tillë nuk e përcakton, sikurse transferimi i realizuar nuk i ka përmbushur asnjërën nga parakushtet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 52, nenit 53 dhe nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, andaj mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: "1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme", Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 13.08.2021 me numër: 10/2021 është vendim i paligjshëm ngase Komisioni Disiplinor ka dal përtej autorizimeve dhe kompetencave ligjore, ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material ndërsa diskrecionit e ka ushtruar në mënyrë jo të ligjshme sikurse palës me arsyetimin e dhënë të këtij vendimi ia ka pamundësuar të kuptojë qëllimin e kësaj mase sikurse në asnjë pjesë të arsyetimit të dhënë nuk ka arritur të arsyetoj mjaftueshëm se pse janë zbatuar apo interpretuar në këtë mënyrë

dispozitat e ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij dhe mbi këtë bazë i njëjti është anuluar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Po ashtu, nga se u tha si më lartë edhe Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, me qëllim të zbatimit të Vendimit të datës 13.08.2021 të Komisionit Disiplinor, po atë ditë me datë 13.08.2023 ka nxjerrë Vendimin Nr.243 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar apo sistemuar përkohësisht në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Koordinim të projekteve në kuadër të Departamentit për Zhvillim dhe Koordinim të Projekteve në Zyrën Qendrore, nga rrjedh se një veprim i tillë është i kundërligjshëm sepse Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së nxjerrjen e vendimit e bazon vetëm mbi Vendimin e datës 13.08.2021 të Komisionit Disiplinor e që në rastin konkret sikurse u konstatua edhe më lartë vendimi i Komisionit Disiplinor ishte i paligjshëm dhe mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material"* Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër Nr.243 i datës 18.03.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së është i paligjshëm ngase i njëjti ka interpretuar gabimisht dispozitat e ligjit material madje nuk iu është referuar fare, vendimi i kontestuar nuk përmban arsyetim dhe këshillën juridike si elemente të detyrueshme të aktit administrativ i cili ka cenuar të drejtat e ligjshme të ankuesit, sikurse termi sistemim i përkohshëm nuk është as i përcaktuar dhe as i rregulluar me ligjin material, si rrjedhojë edhe sikur të ishte transfer i ligjshëm në asnjë rrethanë transferimi i një nëpunësi civil nuk mund të behët në një pozitë të kategorisë më të ulët sesa pozita që e mban sipas nëpunësi sipas aktit të emërimit ngase ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 05.05.2017 me numër:02/600/09 ka qenë i emëruar në pozitën a *"Drejtor i Drejtorisë Rajonale në Gjilan"* në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa është sistemuar në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Koordinim të Projekteve në kuadër të Departamentit për Zhvillim dhe Koordinim të Projekteve në Zyrën Qendrore, pozitë kjo e cila është më e ulët sesa pozita në të cilën ankuesi ka qenë i emëruar duke e dëmtuar ankuesin edhe në pagë, madje sistemimit të përkohshëm nuk i është caktuar as afati kohorë se sa mund të zgjasë, ndërsa me dispozitat e Rregullores nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil rregullohet kjo çështje, gjegjësisht me nenin 4 paragrafi 1 të së njëjtës rregullore përcaktohet se: *"Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit."*, sikurse një vendim i tillë nuk përmbush kriteret e sigurisë juridike se pala pas përfundimit të sistemimit të përkohshëm mund të kthehet në vendin e punës sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 4 paragrafi 5 të së njëjtës rregullore: *"Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme"* duke ia pamundësuar palës kthimin në vendin e tij të punës, gjegjësisht duke e dëmtuar materialisht ngase në asnjë pjesë të akteve të goditura nuk sigurohet se ankuesi do të paguhet me pagë të njëjtë pavarësisht se është sistemuar në pozitë më të ulët.

Prandaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit thekson faktin se kërkesa e ankuesit e datës 27.03.2023 përmes së cilës e ka njoftuar institucionin punëdhënës, respektivisht Kryesuesin Komisionit Disiplinor përmes së cilës kërkesë i njëjti e ka njoftuar institucionin se Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktvendimit PKR.nr.249/2022 të datës 10.02.2023 e ka Hudhë aktakuzën e Prokurorisë dhe ka konfirmuar se ankuesi nuk ka kryer

asnje veprim permes se cilit mund te nxirret ndonje element i kryerjes se ndonje veprimi qe ka elemente te veprës penale, ndersa po ashtu Gjykata e Apelit te Kosovës permes Aktvendimit PN.nr.250/2023 te datës 07.03.2023 e ka vërtetuar Aktvendimin PKR.nr.249/2022 te datës 10.02.2023 te Gjykatës Themelore ne Gjilan-Departamenti per Krime te Rënda, dhe mbi këtë bazë ne rrethanat e rastit konkret paraqitet situatë e re apo rrethanë juridike pas se cilës arsyetimi i përdorur nga institucioni punëdhënës lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore dhe ne te njëjtën kohë edhe e ka realizuar transferimin e ankuesit ne cilësi te masës disiplinore duke e degraduar te njëjtin pavarësisht qe nga shkresat e lëndës vërehet se i njëjti nuk i ka shkelur dispozitat e Ligjit nr.06/L-114 per Zyrtarët Publik, prandaj transferimi ne formë te masës disiplinore përveç qe ka qenë i pabazë tani më edhe duhet te pushoi se ekzistuari si arsyetim, ngase Komisionit Disiplinor me rastin e nxjerrjes se Vendimit te datës 27.04.2021 dhe Vendimit te datës 13.08.2021 e mbështet ne arsyetimin se ndaj ankuesit prokuroria ka ngritur aktakuzë ndersa asnje arsyetim tjetër nuk është përdorur apo thënë më qartë njoftimi i Prokurorisë per ngritjen e aktakuzës apo kallëzimit penal dhe njoftimi i Policisë se Kosovës kanë qenë rrethana juridike apo shkak kryesor qe ankuesit i është iniciuar procedura disiplinore, gjegjësisht i është shqiptuar fillimisht transferimi ne cilësi te masës disiplinore sikurse është shtjelluar edhe më lartë, pastaj është pezulluar procedura e disiplinore e më pastaj ne fund ndaj te njëjtit është nxjerrë masë e përkohshme dhe është sistemuar përkohësisht ne një pozitë më te ulët sesa pozita qe e ka mbajtur permes aktit te emërimit, andaj mbi këtë bazë me rastin e konfirmimit permes dy aktvendimeve, atij te Gjykatës Themelore ne Gjilan-Departamenti per Krime te Rënda dhe atij te Gjykatës se Apelit te Kosovës se ankuesi është liruar nga akuza ngase nuk ka kryer vepër penale, përbëjnë shkak themeltar qe institucioni punëdhënës respektivisht Komisioni Disiplinor dhe Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së është dashur sipas detyrës zyrtare te shfuqizojnë aktet e tyre te cilat paligjshëm kanë qenë duke prodhuar efekte juridike ne dëm te palës, sikurse një çështje e tillë përcaktohet me dispozitat e nenit 53 paragrafi 1 te Ligjit nr.05/L-031 per procedurën e përgjithshme Administrative: *"Një akt administrativ mund te anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik qe ka kompetenca te nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj"*, nga rrjedh se sikurse kërkesa e ankuesit e datës 27.03.2023 ndaj se cilës ka heshtur institucionin punëdhënës ka qenë kërkesë e ligjshme dhe e drejtë, po ashtu edhe ankesa e ankuesit e datës 19.05.2023 e parashtruar ne Këshill është e bazuar dhe si e tillë është aprovuar.

Për sa më sipër dhe duke marr për bazë te gjeturat dhe konstatimet e pasqyruara si më lartë, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Administratat Tatimore e Kosovës, ne rrethanat e rastit konkret ka vepruar ne kundërshtim me parimet e përgjithshme te menaxhimit te zyrtarëve publik te përcaktuara me nenin 7 te Ligjit Nr.06/L-114 per Zyrtarët Publikë si ne vijim: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, ne parimin e mundësive te barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañsisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit te drejtë gjinor dhe te komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë ne detyrë"*, ndersa pas pranimit te vendimit te Këshillit, obligohet qe te veprojë ne pajtueshmëri me te gjeturat, konstatimet dhe detyrimet qe rrjedhin nga ky vendim, duke e bërë te zbatueshëm ne plotni akt emërimit e ankuesit te datës 05.05.2017 me shifër:02/600/09 sipas te cilit ankuesi ka qenë i emëruar ne pozitën *"Drejtor i Drejtorisë Rajonale ne Gjilan"* Departamenti-Shtylla Funktionale Operacionet ne kuadër te Administratës Tatimore te Kosovës, ne te njëjtën kohë duke ia bërë kompensimin ne mënyrë retroaktive te diferencës ne pagë dhe atë qe nga data 13.08.2021.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka pasur parasysh se ankuesi me datë 10.09.2021 kishte parashtruar ankesë në Këshill e regjistruar me shifër A.nr.797/2021 kundër Vendimit të datës 13.08.2021 të Komisionit Disiplinor dhe Vendimit të datës 13.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, mirëpo kjo lëndë nuk është vendosur për shkak se Këshilli asaj kohe ka qenë jo funksional apo pa anëtarë, ndërsa pala është udhëzuar në mjete juridike pranë gjykatës kompetente, mirëpo në rastin konkret janë krijuar rrethana të reja juridike sikurse u përcaktua përmes dy aktvendimeve, atij të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda dhe atij të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe pala pas këtyre rrethanave të krijuara të cilat nuk kanë ekzistuar më herët ka hapur procedurë ankimore ndaj institucionit punëdhënës për shkak të heshtjes administrative.

Lidhur me pretendimet ankimore të palës ankuese si dhe kërkesën e tij që Këshilli të shfuqizojë Vendimin e datës 12.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe Akt Emërimit të datës 13.12.2022 lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të ATK-së, të cilat janë nxjerrë në emër të procedurës së ristrukturimit të Administratës Tatimore të Kosovës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankuesi kundër këtyre dy akteve ka parashtruar ankesë me datë 23.12.2022 e cila në Këshill është regjistruar nën shenjën A.nr.1250/2022, prandaj mbështetur në nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën."*, aktet e kontestuara, gjegjësisht Vendimi i datës 12.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe Akt Emërimit datës 13.12.2022 lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të ATK-së nuk mundën të prodhojnë efekte juridike për ankuesin deri në vendimin që zgjedh ankesën e ankuesit, ngase sipas Vendimit të Këshillit A.nr.341/2021 të datës 24.03.2023 është pezulluar vendimmarrja lidhur me ankesën e ankuesit se bashku edhe me të gjitha ankesat e tjera të kësaj natyrë që janë parashtruar ndaj ATK-së nga nëpunësit civil të punësuar në këtë institucion, për shkak se Këshilli me datë 16.02.2023 ka nxjerrë Vendimi VMK/2023 me numër protokoll:1851/2023 përmes të cilit ka vendosur që të realizojë monitorim të jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës për shkak të numrit jashtëzakonisht të madh të ankesave si pasojë e pakënaqësive të të punësuarve lidhur me procesin e ristrukturimit të brendshëm të ATK-së, e që mbi këtë bazë derisa Këshilli të vendos meritoreisht lidhur me ankesën e ankuesit të datës 23.12.2022 të dy aktet e lartcekura në rrethanat e rastit konkret nuk prodhojnë efekte juridike ndaj palës, nga rrjedh se pala duhet të ushtroi detyrat dhe përgjegjësit që burojnë nga akti i emërimit të datës 05.05.2017 i cili ka mbet në fuqi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.765/2023

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

*Malsore Gashi-Bajraktari*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.